

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NEA Albania” shpk**

Sot, në datë 05.04.2024, unë, themeluesi Eglantina Dervishi, atësia Shaban, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J05811005U, e datëlindjes 11.08.1990, lindur dhe banuese në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar; kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

1. Emri i shoqërisë është “NEA Albania” shpk.
2. Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2
Objekti**

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :
 - a) Dhënia me qira e pasurive të paluajtshme: ofrimi i dhënies me qira afatshkurtër dhe afatgjatë, të apartamenteve, vilave, rezidencave, zona të banimit, shtëpi pushimi, ambiente biznesi, konferenca, garazhe, ambiente të hapura dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme.
 - b) Ofrimi i shërbimeve të konsulencës organizative, administrative, menaxhimit të kontratave dhe shërbime të tjera të ngjashme.
2. Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4
Selia**

1. Shoqëria e ka selinë në: Bulevardi Gjergj Fishta , Pallati 3,Shkalla 5, Ap 25 , Tiranë.
2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5
Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 (Dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Eglantina Dervishi.
2. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6
Administratori**

1. Administrator i shoqërisë emërohet Eglantina Dervishi, atësia Aleksandër, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J05811005U, e datëlindjes 11.08.1990, lindur dhe banuese në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.



Neni 7
Baza Ligjore

1. Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAK I VETËM
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NEA Albania” shpk


Eglantina Dervishi
(Emër, Mbiemër, Firma)

